



22 PRILL DITA E TOKËS - SHQIPËRIA NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E PARISIT



New York - Mbi 175 shtete, mes të cilëve edhe Shqipëria, firmosën në selinë e OKB-së, në New York, një nga

marrëveshjet më të rëndësishme në fushën e mjedisit. Jo pa qëllim marrëveshja e Parisit u firmos më 22 prill 2016, ditë që përkon me festimet që bëhen në kuadër të Ditës së Tokës.

Nënshtkrimi i kësaj marrëveshjeje për Shqipërinë u mundësua nga zëvendës-kryeministri i Qeverisë Shqiptare, z. Niko Pelesh, i cili theksoi se kjo marrëveshjeje rrit përgjegjësitë në nivel kombëtar për zbatimin e detyrimeve të saj dhe konkretisht ndërmarrjen e masave për zbatimin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar.

Marrëveshja e Parisit shënon një moment historik në përpjekjet e komunitetit ndër-

kombëtar në sfidën e ndryshimeve klimatike, e cila ka dëshmuar që arrijet mund të përbushen vetëm duke qenë të bashkuar. Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është mbajtja e rritjes së temperaturës mesatare globale, nën 2 gradë Celsius, deri në fund të këtij shekulli (apo deri 1.5 gradë C sikurse synojnë vendet anëtare), si dhe të forcojë aftësinë për t'u përballur me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Nga kjo ditë, bota ka për herë të parë një marrëveshjeje ligjërisht të detyrueshme dhe universale mbi klimën.

Zbatimimi i Marrëveshjes së Parisit bazohet në parimin e përgjegjësisë të përbashkëta, por të diferencuara, sipas të cilit, të gjitha palët, pavarësisht nëse janë në zhvillim apo të zhvilluara, marrin përgjegjësi për reduktimin e gazeve me efekt serra, sipas kushteve të

secilit vend.

Edhe ministri i Mjedisit z. Lefter Koka në një deklaratë për mediat sociale në këtë ditë theksoi se "Shqipëria është vendosur në krah të vendeve më të zhvilluara të botës, në zotimin e Shqipërisë për të kontribuar në këtë sfidë globale për klimën. Përfshirja jonë në këtë marrëveshjeje historike shërben si një instrument që promovon Shqipërinë, në nivel global".

Përgatitja dhe dorëzimi i Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (INDC) nga ana e Ministrisë së Mjedisit tregon angazhimin e Shqipërisë për arritjen e objektivit global të Konventës Kuarër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Shqipëria është palë në këtë Konventë që prej janarit të vitit 1995.

PREZANTOHET "ROJA E GJELBËR"



Zëvendësministri i Mjedisit, Kledi Xhaxhiu dhe Drejtori i Përgjithshëm për Rendin dhe Sigurinë Publike, pranë

Policiës së Shtetit, Altin Qato, prezantuan zyrtarisht ngritjen e Task-Forcës "Roja e Gjelbër", një strukturë ndërinstitucionale në mbështetje të mbrojtjes së pyjeve.

Zoti Xhaxhiu, në cilësinë e kryetarit të grupit drejtues në nivel politikbërës të Task-Forcës "Roja e Gjelbër", theksoi rëndësinë e krijimit të kësaj strukture për garantimin e moratoriumit 10-veçar të pyjeve.

"Kjo Task-Forcë është përkrahur fuqimisht nga qeveria", u shpreh ai.

Drejtori i Përgjithshëm për Rendin dhe Sigurinë Publike, pranë Policiës së Shtetit, Altin Qato vuri në dukje se "Task Forca funksionon prej disa ditësh 24/24, në pikat kryesore të akteve rrugore

në të gjithë territorin e vendit, duke kontrolluar pikat e nxehta të identifikuar si potenciale për prerje pyjesh, si edhe në subjektet që përdorin si lëndë të parë atë drusore".

Në vijim Qato theksoi se janë 25 pika kontrolli të palëvizshme të alternuara me kontroll territori në pikat më të nxehta. Në plan veprimi të kësaj Task-Force janë parashikuar 420 persona në përbërje të tij. Ai u shpreh se deri tani ka pasur një funksionim normal, ndërsa nga 9 raste të konstatuara nga kjo Task-Forcë, 6 kanë kaluar për procedim penal, 3 autorë janë arrestuar dhe gjobitur në masën 20 milionë lekë të vjetra.

Drejtori i Policiës Pyjore pranë ISHMP-së, Renaldo Gulli garantoi se inspektorët e Institutit të Shërbimit të Mbrojtjes së Pyjeve të përfshira në këtë Task-Forcë, kanë nisur një bashkëpunim intensiv me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera për të siguruar zbatimin me rigorozitet të

mbrojtjes së pyjeve.

Qëllimi kryesor i krijimit të "Rojës së Gjelbër" është rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Kjo Task-Forcë do të forcojë bashkëpunimin ndërmjet strukturave të varësishë së ministrive që përfaqësohen në të, për të marrë masat e nevojshme emergjente për parandalimin, si dhe rihatësimin nga çdo lloj dëmtimi që vjen nga dora e njeriut në pyjet publike dhe private.

Kjo Task-Forcë është e krijuar në tre nivele; grupi drejtues, nga struktura operacionale në nivel rajonal dhe nga struktura operacionale në nivel vendor, ku përfshihen si struktura qëndrore operacionale: Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Tatimeve, si dhe Forcat e Armatosura në rol mbështetës.

RIMBYLLEN AKTIVITETET E FURRAVE TË GËLQERES

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) ka përfunduar aksionin e nisur gjatë muajit mars, në zonën e Krujës dhe Fushë-Krujës për mbylljen e furrave të gëlqeres.

Gjatë këtij aksioni, Inspektorati ka identifikuar ngritjen e paligjshme të katër aktiviteve. Numri i tyre arrinte një total prej 30 furrash për prodhimin e gëlqeres, të cilat janë prishur të gjitha dhe u mundësua mbyllja e plotë e aktivitetit të tyre. Nga këto furra, 13 ushtronin

aktivitetin e paligjshëm në zonën e Borizanës dhe 17 të tjerat në zonën e Krastës, të rrethit Krujë.

Ky aksion filloi gjatë muajit mars me ushtrimin e kontrollit paraprak në këto zona, pas ankesave të banorëve pranë Inspektoriatit.

Kreu i ISHMP-së z. Ergys Agasi paralajmëron se çdo tentativë e rihapjes së katër aktiviteve të paligjshme do të ndëshkohet maksimalisht. Për këto aktivite të paligjshme në kundravajtje

me ligjin, të cilat rrezikojnë shëndetin e qytetarëve, por edhe ndotjen e mjedisit, do të ketë ndëshkime maksimale dhe nuk do të lejohen të ushtrorin aktivitet në kundravajtje me ligjet dhe normat mjedisore.

Në këtë aksion janë revokuar gjithashtu lejet mjedisore për aktivitetin e 3 gurorëve të kësaj zone, për shkeljen e kushteve mjedisore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NË KËTË NUMËR:

22 PRILL DITA E TOKËS - SHQIPËRIA NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E PARISIT —FQ 1

SHQIPËRIA BËHET PJESE E FESTIVALIT EUROPIAN TË ÇILIZMIT —FQ 2

LEJET MJEDISORE —FQ 3

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE— FQ 4

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilituar opinionin publik".

SHQIPËRIA BËHET PJESE E FESTIVALIT EVROPIAN TË ÇIKLIZMIT



14 prill 2016 - Ambasada Hollandeze në kuadër të Presidencës Hollandeze të Bashkimit Evropian, organizoi Festivalin Evropian të Çiklizmit në Tiranë "Let's Bike Tirana", festë e cila mbledhi bashkë përfaqësues të trupit diplomatik në Shqipëri dhe të organizmave të huaj që punojnë në fushën e mjedisit dhe transportit, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Transporteve, Bashkia Tiranë, përfaqësues të shoqërisë civile, si edhe gjimnazistë e qytetarë të apasionuar pas biçikletave.

Ambasadorja Hollandeze znj. Dewi van de Weerd në fjalën e saj theksoi se "Ne përfaqësojmë një vend ku numri i biçikletave është më i madh se numri i banorëve dhe këtë kulturë duam ta përhapim edhe në vendin tuaj, pasi është një formë shumë më e shpejtë dhe më mjedisore. Ky Festival po zhvillohet në të gjitha qytetet evropiane dhe zhvillohet në të njëjtën ditë që janë mbledhur dhe ministrat e Transportit të të gjitha vendeve evropiane, të shpresojmë që vendimet e tyre të ndikojnë në ndjekjen e politikave të duhura për të pasur një transport mjedisor në të gjitha vendet evropiane."

Kryetari i Bashkisë së qytetit të Tiranës z. Erion Veliaj, falenderoi gjithë stafin e ambasadës për këtë nismë që morën, "Unë e kam thënë gjithmonë, ka investime në infrastrukturë dhe investime në kulturë, të dyja kanë rëndësi, por ky i sotmi është edhe një investim në infrastrukturë, siç është kjo rrugë ku ne jemi, por dhe një investim në kulturë me këtë organizim fantastik të Ambasadës Hollandeze".

Zonja Olijana Ifti, zëvendësministre e Ministrisë së Mjedisit në fjalën e saj theksoi se "Është kënaqësi që jemi të gjithë së bashku sot në këtë iniciativë të ndërrmarrë nga Ambasada Hollandeze për t'i dhënë sheshit të Tiranës një pamje të njëjtë me atë të vendeve evropiane, që i janë bashkuar Festivalit Evropian të Çiklizmit. Pjesëmarrja e qytetarëve tanë në krosë të tilla masive tashmë po bëhet pjesë e të menduarit dhe në qytetet tona, por akoma mbetet sfida për ne që të ndryshojmë mentalitetin e banorëve, të cilët për të udhëtuar brenda qytetit të mos përdorin makinën e tyre private, por të zgjedhin alternativat mjedisore të transportit si transportin publik apo biçikletat". Gjithashtu, znj. Ifti theksoi se "Është për t'u përgëzuar Bashkia e Tiranës me iniciativën që po ndërmerr së

fundmi për t'iu dhuruar kalimtarëve dhe përdoruesve të biçikletës, qendrën e këtij qyteti. Këtë do të kërkonim dhe nga kryetarët e bashkive të qyteteve të mëdha në vend, që në politikën e tyre urbane të mendonin më shumë për qytetarin, që ka zgjedhur biçikletën si mjet transporti.

Ne me veprimet tona duhet të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian, i cili ka adoptuar një sërë masash ambicioze për klimën dhe energjinë, të cilat duhet të arrihen deri në 2020. Këto masa përfshijnë një reduktim të lëshimit të gazeve deri në 20%, rritje të efikasitetit të energjisë rreth 20% dhe përdorim prej 20% të energjisë së rinovueshme"- përfundoi znj. Ifti.

Aktiviteti vijoi me pedalinë e përbashkët drejt ambienteve të Ambasadës me fituesit e konkursit "Shkrepe për mjedisin" ku ambasadorja znj. Dewi van de Weerd shpërndau çmimet për tre fituesit për foton më të bukur nga mjedisi, ndërsa për 10 fotot më të bukura do të ekspozohen në Post Festivalin e Çiklizmit.



VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS MARS 2016

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI
1	Alba shpk	VP Ndërtim godine 7-8 kate & 2 kate nëntoke	Tiranë	Plotësim Informacioni
2	Bashkia Fier 1058	VP Rikonstruksion rruge Aim-Ndërrnenas-Hasturkas	Fier	Vendim për VNM Paraprake
3	Bashkia Fier 497	VP Rikonstruksion Ade-Frakull	Fier	Vendim për VNM Paraprake
4	Bashkia Tepelenë 38	VP Rikonstruksion rruge, fshati Peshtan	Peshtan, Tepelenë	Vendim për VNM Paraprake
5	Ben-Land	VP Linjë prodhim betoni & asfalto betoni	Hekal, Mallakastër	Vendim për VNM Paraprake
6	Blerind Biçaku	VP Rikonstruksion dyqani + 1K bodrum	Pazari Vjetër, Krujë	Vendim për VNM Paraprake
7	Cobial	VTH Shfrytëzim guri gëlqeror sip	Bëçëz-Tepelenë	Deklaratë mjedisore
8	Daton	VP Ndërtim, shtesë 8K + 1 kat nëntokë	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
9	Fatjon Jangozi	VP Ndërtim magazine 1 Kat	Durrës	Vendim për VNM Paraprake
10	Klusal	VTH Shfrytëzim guri gëlqeror sip	Ura Vajgurore, Berat	Plotësim Informacioni

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendndodhja	Vendimi
1	Agi Bes	VTH - Shfrytëzim guri gëlqeror	Shishtufinë, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
2	Hidro Seta 1-2	VP - Ndërtim HEC Seta 1-3	Fshati Gurë, Dibër	Vendim për VNM Paraprake
3	Hidro Seta 3	VP - Ndërtim HEC Seta 3	Fshati Gurë, Dibër	Vendim për VNM Paraprake
4	Alba	VP - Ndërtim godine 7-8 kate + 2 K nëntokë	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
5	SS&R	VTH—Shfrytëzim kromi me karrierë	Skroskë, Pogradec	Deklaratë Mjedisore
6	Oberald energjetik	VP - Ndërtim HEC Kryezi	Fshatin Kryezi, Bashkia Fushë Arrëz, Shkodër	Plotësim Informacioni
7	Cagatay Logistics Albania	VP - Godinë Industriale	Vorë, Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
8	Alfa GJ	VP - Ndërtim Hoteli	Gjirokastrë	Vendim për VNM Paraprake

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	Tamara, Bashkia M. Madhe	Rivitalizim i ndërtesave dhe shëtitoreja e lumit Tamarë	Malësi e Madhe	Vendim për VNM Paraprake
2	Bashkia Korçë 680	Kompleks multifunksional arsimor dhe kulturor	Korçë	Vendim për VNM Paraprake
3	Bashkia Pustec	Rikualifikim dhe rikonstruksion të sheshit të Pustecit	Korçë	Vendim për VNM Paraprake
4	Bashkia Tiranë 681	Rikualifikim dhe rikonstruksion të sheshit Avni Rustemi, Pazari i Ri, Markatës së Mishit	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
5	Delu Tailoring Enterprise	Ndërtim godine 3 katëshe me funksione shërbimi	Rrashbull, Durrës	Vendim për VNM Paraprake

LEJET MJEDISORE, PRILL 2016

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI
1.	Benaks 94	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat në qiell të hapur	Pogradec, Korçë	Refuzim
2.	Kurti A	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to	Bulqizë	Miratim
3.	ALKO-IMPEX General Construcion	Transport i mbetjeve jo të rrezikshme, fabrika e qelqit	Tiranë	Miratim
4.	A l b G a r d e n	Grumbullim, transportim, ruajtje riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme	Lezhë	Miratim
5.	Euro Fab	III-2B Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme	Kodër Kamëz, Tiranë	Miratim
6.	Korsel	III-2B Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme	Korçë	Refuzim
7.	Infinitt Construction	III-2B Grumbullim, transportim, ruajtje e mbetjeve urbane	Berat	Miratim
8.	Vëllezërit Gojani	Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerien e çimentos, grumbullimi i betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Shkëzëz, Shkodër	Miratim
9.	Banka e Tiranës	Transferim në Adriatic Free Zone Terminal: Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në çisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një çisternë e lëvizshme, çisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal. b. Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në çisternat e stacioneve të furnizimit me karburant	Rruga "Parku Energjetik i Portoromanos", Durrës.	Miratim
10.	Petromanas LC 9743	Transferim në Shell Upstream Albania B.V: Kërkim i naftës dhe i gazit natyror, nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror. Puse shtesë në projektin ekzistues Shpirag 2 dhe Molisht 1, të kërkimit të naftës	Shpirag 3, (Komuna Sinjë) dhe Shpirag 4 (Komuna Velabisht) të qarkut të Beratit.	Miratim
11.	Petromanas LC 9749	Transferim në Shell Upstream Albania B.V: Kërkim i naftës dhe i gazit natyror; Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror. Puse shtesë në projektin ekzistues	Shpirag 2 dhe Molisht 1, të kërkimit të naftës Shpirag 2, (Komuna Sinjë) dhe Molisht 1 (Komuna Velabisht) të qarkut të Beratit.	Miratim
12.	Petromanas LC 9834	Transferim në Shell Upstream Albania B.V: Kërkim i naftës dhe i gazit natyror. Puset e naftës Shpirag 2 dhe Molisht 1	Komuna Sinjë, Berat	Miratim
13.	Babani.MG	Thertore	Fshati Shelqet, Vau Dejës, Shkodër	Miratim
14.	Mare Adriatik	Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqëve	Fshati Shelqet, Vau Dejës, Shkodër	Miratim
15.	BE-IS shpk	III.2.B Grumbullim dhe transportim i mbetjeve te llojeve të ndryshme	Fshati Muçaj, Vorë, Tiranë	Miratim
16.	EGLAND	Ndryshim- Ishte "Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim, asgjësim i mbetjeve plastike, u bë " Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim, asgjësim i mbetjeve plastike. Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve te ndryshme.	Bulqizë	Miratim

VLOJNË KONTROLLET E INSPEKTORIATIT TË MJEDISIT PËR ZBATUESHMËRINË E LIGJIT



Prej disa javësh Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, (ISHMP), ka nisur ushtrimin e kontroleve në rang vendi për hedhjen dhe trajtimin e mbetjeve spitalore.

Inspektoriati ka përfunduar kontrollin e ushtruar në Qarkun Korçë, ku ka rezultuar një situatë e rëndë mjedisore dhe shkelje flagrante e detyrimeve ligjore dhe çdo akti mjedisor, për menaxhimin e mbetjeve spitalore nga ana e spitalit rajonal Korçë dhe kompanisë së kontraktuar për trajtim deri në asgjësim të këtyre mbetjeve.

Bazuar në ligjin 10463 neni 52, datë 22.03.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" spitali rajonal i Korçës për

kundërvajta administrative është gjobitur në masën 1.500.000 lekë të reja, për mos zbatimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore.

Pas kontrollit të ushtruar nga ISHMP-ja për mbetje spitalore, bazuar në ligjin 10463, neni 44, datë 22.03.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" kompania e licensuar nga spitali rajonal Korçë, si aktivitet për përpunimin e trajtimin e mbetjeve spitalore, është gjobitur me masën 1.500.000 lekë të reja, pas konstatimit se kompania ka pasur mbetje të papërpunuara.

Nga ana e Inspektoriatit është proceduar me kallëzim pranë organeve të drejtësisë administratori i kompanisë.

Kreu i ISHMP-së, Ergys Agasi, shprehet se ISHMP do të ushtrojë të gjitha kompetencat e saj ligjore, në sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët shqiptarë, si dhe do të penalizojë me ndëshkime maksimale të gjithë ato institucione, subjekte apo individë pa asnjë tolerancë, që do të ushtrojnë aktivitet në kundërvajtje me ligjet dhe normat mjedisore duke vënë në rrezik shëndetin e qytetarëve.

ISHMP-ja po vijon kontrollin dhe inspektimin për situatën në qarqet e tjera të vendit për administrimin dhe menaxhimin e mbetjeve spitalore.



TË MBJELLIM NGA NJË DRU

*T'mbjellim të gjithë nga një dru,
e çdo dru ta sjell' një zog,
e çdo zog ta sjell' një këngë,
e çdo këngë një kënaqësi,
ajër të pastër në mushkëri,
e çdo gjeth me jetë të vet,
pluhurin mbi ty - e pret,
si ombrellë,*

që t'kesh – shëndet.

*Vetëm dubet – pak kujdes,
pak kulturë e pak vullnet...
e të zbrësë mali në qytet.*

*Do t'i dëgjojmë çu-ci,
zogjitë e tu e zogjitë e mi.*

Agim Deva

SEKTORI I TRANSPARENÇËS DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



EDEN- DITA E TOKËS PRANË FËMIJËVE
Qendra EDEN zhvilloi një sërë aktiviteteve edukative ndërgjegjëse për mjedisin me nxënës të dy shkollave 9-vjeçare në Tiranë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës – 22 prill 2016.

Shkollat e përzgjedhura nga kjo qendër ishin shkollat nën-tëvjeçare “Sabaudin Gabrani” dhe “Dora d'Istria”, gjithashtu aktivitetet u zhvilluan edhe në Qendrën e Edukimit Mjedisor “EDEN” pranë Kopshtit Zoologjik.

Në të dy shkollat u mbollën fidanë bimësh të ndryshme nga vetë nxënësit, të cilët jo vetëm që përvetësuan teknikën e mbjelljes së bimëve dhe përkujdesit të tyre, por mëson dhe një sërë njohurish mbi faktet pozitive, që këto bimë ofrojnë ndaj ambientit dhe njerëzve. Bimët që u mbollën gjatë kësaj dite ishin: dafina, rozmarina, oleandër, jaseminë, si dhe lule dekorative.

Gjithashtu, loja interaktive edukuese u zhvilluan në Qendrën e Edukimit mjedisor në Kopshtin Zoologjik, për zhvillimin e kulturës dhe dashurisë ndaj mjedisit prej fëmijëve të shkollës “Sabaudin Gabrani”.

Fëmijëve iu zhvilluan loja për zhvillimin e mendimit kritik për çështjet mjedisore, si dhe një shpjegim historik mbi ditën e tokës dhe shpizës ekologjike “EDEN”.

Fëmijët vizituan edhe kafshët e kopshtit duke marrë dhe informacion të përgjithshëm mbi to dhe kopshtin zoologjik në vetvete.

Tema e këtij viti ishte “Pamë për Tokën”. Qëllimi i kësaj teme është të përcjellë një ndikim të rëndësishëm dhe të matshëm në Tokë i cili do të shërbejë për një planet të pastër, të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për të gjithë. 22 prill është një ditë e veçantë, e dedikuar për të gjithë ata që u intereson të kujdesen për Tokën. Kjo ditë synon të rishtë ndërgjegjësimin e mundësive për të përmirësuar çështjen e ndryshimeve klimatike dhe shfrytëzimin e burimeve në mbrojtje të mjedisit.

Gjithashtu, më 22 prill u nënshkrua marrëveshja mbi mbrojtjen e klimës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina dhe 120 shtete të tjera të cilat ishin pjesë në konferencën e Parisit për ndryshimet klimatike në 2015.

Qendra EDEN falenderon stafin dhe nxënësit e shkollave që ishin pjesë e festimit të kësaj dite të rëndësishme për tokën. Ky event u mbështet nga projekti “Përspektivë drejt integritimit në BE - angazhim i qytetarisë aktive dhe shoqërisë civile në politikën mjedisore”, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) - programi ACHIEVE, financiar nga Bashkimi Evropian.

QËNDRA E INFORMACIONIT AARHUS VLORE

Në kuadër të ditës së tokës dhe të iniciativës për Reduktimin e risqeve ndaj katastrofave natyrore dhe industriale, Qendra



e Informacionit Aarhus Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe me mbështetjen e OSBE-së, Prezenca në Shqipëri, organizoi konsultimin e parë publik me banorë të zonës, grupe interesi, përfaqësues të administratës dhe kryetarët e fshatrave të njësisë Administrative Orikum.

Gjatë realizimit të konsultimit publik, autoritetet publike dhe investitorët, u kërkoi qytetarëve, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile, mendime, ide, sugjerime dhe alternativa rreth një teme të caktuar, një çështje, një plani apo programi zhvillimi. Konsultimi zakonisht nënkupton informimin e qytetarëve, grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, nga autoritetet publike dhe investitorët, për zhvillimet e ndryshme të politikave, planeve, programeve dhe kërkesën për komente, qëndrime, sugjerime dhe alternativa.

Ky konsultim publik, ishte i pari i këtij lloji që u organizua në Orikum, në Ditën e Tokës, dhe kishte si qëllim:
- shkëmbimin e eksperiencave nga aktorë të ndryshëm për rastet e zjarrvënies në këtë njësi administrative;
- bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm lokal dhe banorëve për të reduktuar në maskimum zjarrvënien në zonën e Orikutit;

- ndërgjegjësimin e komunitetit dhe grupeve të interesit për të mbrojtur pyjet, natyrën në këtë zonë;
- krijimin e një modeli të mirë dhe funksional për zhvillimin e konsultimeve publike për shumë çështje, probleme dhe shqetësime dhe si investime të ndryshme me qëllim që banorët dhe grupet e interesit të ndihen të përfshirë dhe të kontribojnë në zhvillimin ekonomik të zonës.

Në përfundim të këtij konsultimi u mundësua:
- hartëzimi i risqeve potenciale në komunitetin e Orikutit dhe;
- vlerësimi i rrisikut ndaj katastrofave natyrore dhe industriale.

AARHUS VLORE - NË FOKUS INFORMIMI PËR KATASTROFAT NATYRORE

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe me mbështetjen e OSBE-së, Prezenca në Shqipëri, është duke zbatuar një nismë për reduktimin e rreziqeve nga Katastrofat natyrore dhe industriale në Bashkinë e Vlorës. Kjo nismë synon të rishtë ndërgjegjësimin e të rinjve dhe të qytetarëve për të qenë të përgatitur në rastin e katastrofave natyrore dhe industriale, si dhe të bashkërendojë punën dhe veprimet e institucioneve publike vendore për minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.

Sot është aktiviteti i parë i kësaj nisme, në kuadrin e ndërgjegjësimin, me nxënës të shkollës Aulona, aktiviteti i cili synon ndërgjegjësimin e nxënësve për mirëpërdorimin e bombolave të gazit në ambientet e shtëpisë së tyre, për të eliminuar rreziqet e mundshme që mund të ndodhin.



Ky takim do të pasohet nga takime të tjera në shkolla dhe me konsultime publike e forume qytetare në zona potencialisht të rrezikuara të Bashkisë Vlorë nga rreziqet e ndryshme natyrore, si përmbytjet, zjarret, erozioni dhe rrëshqitjet e dheut. Këto konsultime do të organizohen në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë në Njësitë administrative Novoselë, Orikum, Shushicë dhe Qendër.

LIQENI ARTIFICIAL TIRANË—LLOJ I RI BRESHKË UJI

Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë



Nga monitorimet për faunën, që po kryhen tek Liqeni i Tiranës, nga Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë (ASPBM), është evidentuar një lloj i ri breshke për Shqipërinë. Breshka është lloj alien (dominus) amerikan i introduktuar në Evropë para shumë vitesh, por për Shqipërinë nuk ka pasur të dhëna për egzistencën e saj. Lloji i zbuluar i bashkohet dy llojeve të tjera të breshkave të ujërave të ëmbël, duke e rritur numrin në tre të tilla. Breshkujza quhet red-eared slider (Trachemys scripta elegans), e cila është një specie e listuar si një ndër 100 llojet më invazive në botë sipas IUCN. Kjo specie ka përhapje të gjërë në Evropë si rezultat i përdorimit të saj si kafshë shtëpiake. Biologu i shoqatës, Prof. Ferdinand Bego, praninë e saj e lidh me mundësinë që dikush mund ta ketë lëshuar në liqen. Gjithesesi gjatë muajve në vijim do të kryhet një studim mbi sjelljen e saj riprodhuese, numërin e individëve, shpërndarjen, sjelljen me llojet e tjera të breshkujzave.

SHOQATA "EKSPERTËT E RINJ MJEDISOR" (SHERM)

Kjo shoqatë mjedisore zhvilloi një takim me nxënësit e shkollës Trebeshit, për Edukimin Mjedisor dhe mbrojtjen e Biodiversitetit. Gjatë takimit, i cili u organizua në një formë trajnimi, u sqarua rëndësia e biodiversitetit në jetën e tonë; ku mbrojtja, humbja, dëmtimet që pasojnë atë nga aktiviteti jetësor, impakti që ne kemi në mjedis duhet të kombinohen me masat që ne duhet të marrim për mbrojtjen e këtij mjedisi në përgjithësi dhe biodiversitetit në veçanti.

Problemët e zonës së Trebeshit, Bulqizës, situata mjedisore aktuale si problemet me mbetjet, shpyllëzimet, gjuetia e një sërë problemesh reale që shqetësojnë edhe fëmijët u bë objekt i diskutimit, që shoqëroi gjithë aktivitetin.

Ky aktivitet u mundësua në kuadër të Projektit Eeonord financiar nga Delegacioni Evropian në Shqipëri dhe zbatohet në Bulqizë nga SHERM.

Nga aktiviteti u vu re një interesim në rritje i banorëve të zonës. Gjatë aktivitetit u shpërndanë dhe një sërë broshurash për mjedisin të mundësuar nga shoqata.

